

AKT KRIJIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR ME ORTAK TE
VETEM "DISTRIBUTION MARKETING" shpk

Ne daten 1.08.1997, une Vilma Nushi, e bija e Besnikut dhe e Shpreses, lindur ne Tirane ne 30.6.1961 dhe banuese ne Tirane, rruga Ismail Alla, P.16/I Ap16,

VENDOSA

Neni 1

Te krijoj nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar me ortak te vetem te emertuar " Marketing Distribution" shpk, ketu me poshte e quajtur "shoqeria"

Neni 2

Selia e shoqerise eshte ne Tirane, rruga Ismail Alla, P.16/I Ap16, Shqiperi.

Neni 3

Kohezgjatja e shoqerise eshte per nje periudhe prej 20 vjetesh duke filluar nga data e regjistrimit te shoqerise ne regjistrin tregtar dhe mund te zgjatet ne perputhje me dispozitat perkatese te Statutit te shoqerise.

Neni 4

Shoqeria ka si objekt te veprimtarise saj:

- te bleje apo zoteroje ne ndonje menyre tjeter, te importoje, magazinoje, ruaje, eksportoje apo tregtoje me shumice e pakice mallra te ndryshme, perfshire ato ushqimore, buqesore e blegtoreale, industriale, lende te para e minerale, karburante e kimikate e cdo lloj malli tjeter
- te ushtroje veprimtari te Duty Free Shop , ne perputhje me dispozitat ne fuqi
- Shoqeria ka gjithashtu te drejte te kete pjesmarrje ne shoqeri te tjera shqiptare apo te huaja si dhe te ndermarre cdo akt financiar, ekonomik apo tregtar te lidhur me objektin kryesor te saj dhe qe gjykohet i nevojshem

apo i leverdiss hem per te.

Neni 5

Kapitali i shoqerise ne daten e firmosjes se ketij akti eshte 100 000 lek, i ndare ne 100 pjese kapitali me vlore 1000 lek secila.

Une ortaku i vetem, Vilma Nushi, nenshkr uaj dhe i transferoj shoqerise nje kontribut ne para me vlore 100 000 lek, teresisht te shlyer.

Vlera e kontributit te transferuar shoqerise vertetohet nga dokumenti me emrin e ortakut te vetem dhe shumen e paguar prej tij, leshuar nga banka perkatese.

Neni 6.

Une, Vilma Nushi pranoj dhe garantoj qe pasi kam marre dokumentin per kontributin e kapitalit, vlera e shenuar ne te eshte ne perputhje me vleren e nenshkruar prej meje si kontribut ne para per shoqerine.

Ne perputhje me kontributin tim, zoteroj 100 pjese kapitali te barabarta me 100% te kapitalit te shoqerise ne krijim e siper.

Neni 7

Shoqeria do te administrohet nga nje administrator i vetem. Si administrator i pare i shoqerise eshte Vilma Nushi, e bija e Besnikut dhe e Shpreses, lindur ne Tirane ne 30.6.1961 dhe banuese ne Tirane, rruga Ismail Alla, P.16/l Ap16.

Neni 8

Administratori i pare i shoqerise ne krijim e siper ngarkohet te kryeje tere aktet e nevojshme administrative apo juridike per regjistrimin e shoqerise ne krijim e siper ne regjistrin tregtar.

Neni 9


Vlefshmeria, interpretimi e zbatimi i ketij akti behet ne perputhje me ligjet e Republikes se Shqiperise

Vilma Nushi

Vilma Nushi

YJL

REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E DREJTESISE
NOTERIA TIRANE




Nr1859 rep
Nr1116 kol

VERTETIM

Sot ne date 06-08.1997, para meje noteres se Tiranes, u paraqit personalisht zj. Vilma Nushi, e bija e Besnikut dhe e Shpreses, lindur ne Tirane ne 30.6.19961 dhe banuese ne Tirane ne rrugen Ismail Alla, P16/1, Ap16, madhore, me zotesi te plete juridike per te vepruar, mbi identitetet e se ciles u sigurova nga dokumentat perkates te identitetit, e cila me deklaroi se sa me siper eshte nje akt krijimi i nje shoqerie me perjegjesi te kufizuar me ortak te vetem i hartuar jashtekesaj zyre, dhe e firmos ate rregullisht para meje. Une noteria e vertetoj sipas ligjit.

NOTERI



STATUT
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR ME ORTAK TE
VETEM "MARKETING DISTRIBUTION" shpk

Kapitulli I

Forma-Selia-Kohezgjatja

Neni 1

Eshte krijuar shoqeria me pergjegjesi te kufizuar me ortak te vetem e emertuar "Marketing Distribution" shpk, ketu me poshte e quajtur "shoqeria"

Neni 2

Selia e shoqerise eshte ne Tirane, rruga Ismail Alla, P.16/1 Ap16, Shqiperi.

Neni 3

Kohezgjatja e shoqerise eshte per nje periudhe prej 20 vjetesh duke filluar nga data e regjistrimit te shoqerise ne regjistrin tregtar dhe mund te zgjatet me vendim te ortakut te vetem. Shoqeria mund te krijoje perfaqsi, dege apo filiale, si brenda ashtu edhe jashte vendit, ne perputhje me legjislacionin perkates.

Neni 4

Adresa e ortakut te vetem per te gjitha ceshtjet qe lidhen me shoqerine eshte ajo qe figuron ne librin e ortakeve. Ne se ortaku i vetem nuk gjendet ne kete adresë, atehere cdo njoftim duhet te dergohet ne seline e shoqerise.

Kapitulli II

Objekti i shoqerise

Neni 5

Shoqeria ka si objekt te veprimtarise saj:

-te bleje apo zoteroje ne ndonje menyre tjeter, te importoje, magazinoje, ruaje, eksportoje apo tregtoje me shumice e pakice mallra te ndryshme, perfshire ato ushqimore, buqesore e blegtorale, industriale, lende te para e minerale, karburante e kimikate e cdo lloj malli tjeter

- 
- te ushtroje veprimtari te Duty Free Shop , ne perputhje me dispozitat ne fuqi
 - Shoqeria ka gjithashtu te drejte te kete pjesmarje ne shoperi te tjera shqiptare apo te huaja si dhe te ndermarre cdo akt financiar, ekonomik apo tregtar te lidhur me objektin kryesor te saj dhe qe gjykohet i nevojsphem apo i leverdissuem per te.

Kapitulli III

Kapitali i shoqerise

Neni 6

Kapitali i shoqerise eshte 100000 lek, i ndare ne 100 pjesa kapitali me vlore 1000 lek secila.

Neni 7

Kapitali i shoqerise mund te rritet apo zvogelohet me vendim te ortakut te vetem.

Neni 8

Pjeset e kapitalit te shoqerise jane lirisht te transferueshme ne rruge trasheginie apo ndarjeje bashkeshortore. Cdo transferim i pjesave te kapitalit nje pale te trete duhet te miratohet nga ortaku i vetem.

Neni 9

Pjeset e kapitalit te shoqerise jane te pandashme. Cdo barresim mbi pjeset e kapitalit duhet te miratohet nga ortaku i vetem dhe te regjistrohet ne librin e ortakeve.

Kapitulli IV

Asambleja

Neni 10

Ortaku i vetem vepron ne cilesine e asamblese se ortakeve dhe ka tere kompetencat e asamblese se ortakeve.

Neni 11

Ortaku i vetem ne vecanti vendos edhe per ceshtjet e meposhtme:

- 
1. gjykon e miraton llogarite vjetore dhe politiken e dividenteve
 2. cakton administratorin e vetem dhe ekspertin kontabel te pavarur.
 3. cakton pagen e administratorit te vetem dhe shperblimin e ekspertit kontabel te pavarur.
 4. vendos per transferimin e pjeseve te kapitalit paleve te treta
 5. vendos per cdo lloj barresimi mbi pjeset e kapitalit te shoqerise
 6. vendos per cdo barresim mbi mjetet e shoqerise
 7. vendos per cdo kontrate qe ka te beje me pasurine e patundeshme te shoqerise
 8. vendos per cdo financim apo kredi afat-mesme apo afat-gjate
 9. vendos per cdo ndryshim te rendesishem te natyres se biznesit te shoqerise
 10. vendos per cdo ndryshim ne aktin e krijimit dhe statutin e shoqerise
 11. vendos per cdo ceshtje qe ne perputhje me kete akt eshte ne kompetence te administratorit te vetem, por qe administratori i vetem ja ka deleguar me shkrim ortakut te vetem

Kapitulli V

Administrimi

Neni 12

Shoqeria administrohet nga nje administrator vetem i emeruar nga ortaku i vetem. Administratori mund te jete edhe nje pale e trete jo ortak. Administratori perfaqson shoqerine ndaj te treteve.

Neni 13

Administratori ka kompetencat e meposhtme:

- merr cdo vendim qe lidhet me veprintarine e perditeshme te shoqerise
- firmos kontrata ne emer te shoqerise

- operon me llogarine bankare te shoqerise
- kryen cdo veprim tjeter qe nuk eshte ne kompetence te ortakut te vetem

Administratori mundet qe me dokument te shkruar, ti kaloje nje pjese te kompetencave te tij nje personi tjeter, qofte edhe i trete.

Kapitulli VI

Llogarite vjetore dhe shperndarja e dividentit

Neni 14

Viti tatimor mbyllt ne 31 dhjetor te cdo viti kalendarik

Administratori i vetem, brenda kufijve kohore te percaktuar nga legjislacioni, pergatit llogarite vjetore. Llogarite vjetore miratohen nga ortaku i vetem.

Neni 15

Fitimi neto i shoqerise, pas zbritjes se nje shume te barabarte me 5% te tij per rezerven ligjore, disponohet nga ortaku i vetem i cili vendos per menyren e perdonimit te tij. Rezerva ligjore eshte fiksuar ne masen 10% te kapitalit te shoqerise.

Kapitulli VII

Likuidimi dhe mbyllja e shoqerise

Neni 16

Shoqeria mbyllt kur:

- ortaku i vetem vendos per mbylljen e saj
- ne fund te mbarimit te afatit te kohezgjatjes te percaktuar ne kete akt dhe kur ortaku i vtem nuk ka marre vendim per zgjatjes e ketij afati.
- per cdo arsyet tjeter ligjore

Neni 17

Vendimi per mbylljen e shoqerise deklarohet nga ortaku i vetem, i cili emeron edhe likuidatorin.

Neni 18

Kapitalet e vete te shoqerise qe mbeten pas kryerjes se tere pagesave te percaktuara nga legjislacioni perkates, i takojne ortakut te vetem.

Kapitulli VIII

Egjidhja e mosmarreveshjeve

Neni 19

Cdo mosmarreveshje ndermjet shoqerise dhe administratorit te vetem, apo shoqerise dhe nje pale te trete, do te synohet te zgjidhet ne rruge miqesore. Ne se nje gje e tille nuk do te mund te arrihet, atehere palet do ti drejtohen per zgjidhje nje gjykate kompetente shiptare. Ligji i zbatueshem do te jete ai shqiptar.

Hartuar ne Tirane ne 1.8.1997

Vilma Nushi

